



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr.60/01-22030/25
Kaçanik, 02.09.2025

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 08.09.2025 (e hënë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të KPF-s të datës 08.09.2025, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028;
3. Propozim Vendimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (2025-2030).



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-16744/25
Kaçanik, 24.07.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24.07.2025, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Edona Luzha.

Nga Ekzekutivi i Komunës, pjesëmarrës ishte: Bahri Selimi-DBF, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Valdrin Dogani- ZKF, Fatlume Guri-Selimi- Zyra e Informimit, Mavije Murseli- Zyra e Kryesuesit të KK, Makfire Malsiu-Zyra e KK.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të KPF-së për vitin 2025, data 24.07.2025, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2025;
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;
4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2024;
5. Raporti Gjashtëmujor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025;
6. Propozim Vendimi për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2025 të datës 24.06.2025/ Lënda: 01Nr.60/01-13665/25.

2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i Financave, Bahri Selimi është këtu për sqarime të nevojshme, prezentë është edhe Valdrin Dogani-ZKF. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Raporti i cili po vjen në këtë formë, unë e kam kritikuar vazhdimisht, përsëri ka ardhur i njëjtë raporti, sidomos të IK. Në tabela të IK, shënohet planifikimi dhe realizimi, e në realitet realizimi nuk ka ndodhur. Janë potencuar në faqen e fundit shpenzimet sipas vendimeve të gjykatave. Është mirë me i ndarë shpenzimet sipas vendimeve të gjykatave, mos me i përfshirë të IK. Këtë e kam potencuar edhe me herët, me ditur saktë sa janë planifikuar dhe sa janë realizuar. Shuma prej 70 mijë euro, që është të vendimet e gjykatave të mallrat dhe shërbimet. Çka përfshijnë këto shpenzime? Sa janë në total shpenzimet sipas vendimeve të gjykatave dhe sa janë në total shpenzimet për IK?

z. Valdrin Dogani-ZKF: Nëse e shihni, shpenzimet të MSH janë të ndarë në sektorë. Janë 70 mijë euro të shpenzuara të MSH në total. Të Zyra e Kryetarit sipas vendimeve të gjykatave, 41€. Ky është një rast për një gjobë që e kemi dërguar me herët në përmbarrim, për mos pagesë. Të arsimit është vlera 66 mijë euro për kontratën kolektive, dhe të shëndetësia 3930€, këto janë shpenzimet për paga jubilarë në shëndetësi në bazë të vendimeve të gjykatave.

z. Agim Mani: Shuma 66 mijë euro, a janë për shpenzimet të kontratës kolektive në arsim?

z. Valdrin Dogani-ZKF: Po, shuma 66 mijë euro janë për kontratën kolektive në arsim. Nëse e sheh në raport, në faqen e fundit pas projekteve, janë bërë shpalosje. P.sh. 18028 shërbimet publik, për projektin kapital 194.845.65€, për kontratën kolektive në arsim nga ky projekt janë marrë 12,926.82€. Në total prej IK janë marrë 560 mijë euro janar-qershor për shpenzime në bazë të vendimeve gjyqësore, plus 70 mijë janë marrë nga MSH, gjithsej 630 mijë euro në total.

z. Agim Mani: Të Arsimit, janë planifikuar 200 mijë të IK, thuhet se janë realizuar 200 mijë. A është realizuar kjo shumë e mjeteve?

z. Bahri Selimi: Nuk janë realizuar, por janë shpenzuar për kontratën kolektive në arsim.

z. Valdrin Dogani: Po janë shpenzuar për kontratën kolektive në arsim.

z. Agim Mani: Çështja është se të ky investim, nuk janë shpenzuar mjetet për investime kapitale.

z. Bahri Selimi: E kërkoje Agim pse e paraqesim ne si shpenzime. Raporti i gjeneruar prej sistemi, del se mjetet nga ky projekt janë marrë fiks 200 mijë euro për realizimin e kontratës kolektive në bazë të vendimeve gjyqësore. Të secili projekt në shpalosje janë specifikuar mjetet që janë marrë, për zbatimin e vendimeve të gjykatave.

z. Rrustem Zenuni: Nga raporti shihet se të HVK të tatimi në tokë, ka pasur një ngritje, ndërkaq ulje ka pasur të tatimi në pronë. Unë e vlerësoj angazhimin e qytetarëve që i kanë kryer obligimet ndaj komunës të tatimi në tokë, se ka filluar një proces i frikshëm, ndërkaq i shprehi shqetësimet e mia të tatimi në pronë, se ka indikator që kanë ndikuar në rënie e të hyrave të ky program buxhetor. Unë prapë qëndroj prapa fjalës time, se na duhet një lloj kushtëzimi për me i inkasuar disa tatime. Ka qenë kushtëzimi për tatimin në pronë për regjistrim të veturave, dhe ai kushtëzim që nuk është më, po ndikon në inkasim të tatimit në pronë, kjo iu kushton edhe qytetarëve, se ata e patëm bërë si traditë se e kanë bërë pagesën e TP në momentin që i kanë regjistruar automjetet. Në komunikime dhe debate me qytetarë, ka pasur shumë nga ta që nuk janë pajtuar me heqjen e një kushtëzimi të tillë, se nuk po e kryejnë tani me kohë tatimi në pronë dhe kjo po na kushton me rritje të kamatave. Ulje të HVK ka edhe të inspektorët, por kjo ka të bëjë me vetëdijen e qytetarëve që nuk bien ndeshë me ligjin që me iu shqiptohet gjoba.

z. Agim Mani: Rrustemi theksoj se krahasuar me vitin e kaluar, ka ngritje të TP, ndërkaq në anën tjetër thotë se duhet me kushtëzuar qytetarin. Unë mendoj se është e padrejtë me kushtëzuar qytetarin kur ka ngritje të TP, se kjo është një e padrejtë që i bëhet qytetarit. Absolutisht jam kundër kushtëzimit të qytetarëve për pagesën e TP. E kam një pyetje: Të furnizimi me gjenerator i shkollave, "Kadri Zeka" dhe "Nazmi Osmani", janë planifikuar 60 mijë euro. A keni menduar se është shumë e e madhe 60 mijë euro për këtë projekt?

z. Valdrin Dogani: Është fjala për furnizim me gjenerator për 5 shkolla.

z. Bahri Selimi: Është fjala për furnizim me gjenerator të me shumë shkollave, por teksti nuk ka dalë komplet.

znj. Ardita Rrahmani: Nga raporti, shihet se ka diskrepancë të madhe në mes planifikimit dhe realizimit, sidomos të taksat komunale për leje të ndërtimit, e krejt e dimë si rezultat i kujt po vjen. Lë të jetë një thirrje, kushdo që jemi në legjislaturën vijuese, me ngritur zërin për PZHK, sepse kjo është njëra nga pasojave që jemi duke u ballafaquar. 267 mijë euro janë planifikuar për taksë për leje ndërtimi, kurse realizimi i planit në këtë 6 muaj, është 2%, e që kujtoj se deri në fund të vitit nuk mund të arrijë as 15%. Kjo gjendje ka qenë edhe në vitin e kaluar.

z. Bahri Selimi: Shqetësimi i juaj, është me vend Ardita.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të subvencionet dhe transferet, është një shumë 16,200€ për pagesa për përfitues individual - ndihma çasti. E di që kryetari ka të drejtë me dhënë ndihma çasti për qytetarët, por a po iu duket kjo shumë e madhe drejtor, se nëse llogarisim 100 qytetarë nga 100€, i bien se kanë përfituar 162 qytetarë. A ka komision që bënë vlerësimin apo është e drejtë e kryetarit me i nda këto mjete, se ne duhet me ditur se apo shpërndahen këto mjete në krejt pjesët rurale apo vetëm në qytet, se ne si KK nuk e

dimë ku shkojnë kjo shumë e mjeteve, pos kryetarit dhe deri në çfarë shumë ka të drejtë kryetari me i ndarë këto mjete, se janë shumë për 6 muaj këto mjete me u ndarë. A i ndanë këto mjete vetëm kryetari apo edhe shëndetësia? A bëhet raport detaj 6 mujor për këto mjete të ndara? Duhet me i pasur të dhënat në një raport për rastet që kanë marrë nga këto mjete, se dikush mundet me përfituar e dikush jo?

z. Bahri Selimi: Kryetari ka të drejtë me ndarë deri në 500€ mjete për ndonjë rast të djegies së ndonjë shtëpie apo të ngjashme dhe për ndonjë sëmundje të rëndë. Shëndetësia nuk japin fare për rastet, jep mirëqenia sociale, por shumë pak jep mjete, ato janë raste tjera. Po ka raport, bëhet raporti për krejt mjetet që ndahen, ndarja e mjeteve bëhet sipas kërkesave të palëve, pas vlerësimit të tyre.

z. Rrustem Zenuni: Unë i kam pa vendimet të publikuara në faqen zyrtare të komunës, që ndahen për rastet e caktuara nga kryetari i komunës. Besoj se publikohen edhe për këto që janë ndarë në vitin 2025 dhe kam me i përcjellë a po publikohen përsëri.

z. Valdrin Dogani: Ka kërkesa që adresohen për ndihmë çasti, ndërkaq për shumën 60 mijë euro për gjenerator që janë ndarë, janë për shkollat: “Kadri Zeka”, “Nazmi Osmani”, “Idriz Seferi”, “7 Shtatori”, “Jusuf Gërvalla”, “Ali Asllani”, “Agim Bajrami”, “Gafurr Luma”.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë shënuar shkollat, por i ka nxënë rubrika. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky raport financiar t’i kaloj KK në procedurë? Njëzëri ishin të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Raportin Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2025.

3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Raportin e keni marrë, raporti publikohet edhe në faqen zyrtare të ZKA. Sivjet nuk na ka pëlqyer si raport, por është çështje e kontratës kolektive që i ka paralizuar në çështje të raportit të auditimit. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Për me arsyetuar pjesëmarrjen, se raportin kemi me diskutuar edhe në KK, është për kritikë të fazat për konkluzione të A2, A3, A4, si vonesat në pagesat e obligimeve financiare. Është e paqartë se si janë zhvilluar procedurat të prokurimit, kur nuk ekziston projekti. Këto është mirë me i diskutuar edhe në KK.

z. Agim Mani: Është absurde me u zhvilluar procedurat e prokurimit pa projekt, ne vazhdimisht e kemi kritikuar, ne kemi qenë opozitë dhe na keni pa me sy krejt tjetër dhe po shihet se ne kemi pasur të drejtë. Është për keqardhje që ekzekutivi i komunës është në rënie ndaj përgjegjësive të qytetarëve.

z. Rrustem Zenuni: Raporti i auditimit nuk është bash i mirë, ku sivjet nuk jemi përfitues të GP, ne i dimë si rezultat i kujt na vjen ky raport i auditimit, për shkak të kontratës kolektive. Ne e dimë që vitin e kaluar si rezultat i angazhimeve të ekzekutivit dhe tona, komuna ka qenë përfitues i GP mbi 800 mijë euro.

z. Agim Mani: Nuk besoj që kontrata kolektive ka ndikuar që me u zhvilluar procedurat e prokurimit pa projekt.

Kryesuesi i Kuvendit: Ato që janë potencuar në raport, janë edhe rubrikat ku duhet me i plotësuar pse kanë ndodhur këto. Përgjigjet i jep komuna, se duhet me u pajtuar, se nuk ka mundësi raporti i auditimit në asnjë komunë me dalë pa të gjetura. Raporti tregon se ku jemi ne si komunë, megjithëse ka vite që raporti që ka qenë i mirë, ku kemi qenë që sa vite përfitues i GP, është hera e parë që është i tillë, ndoshta për shkak të disa proceseve, se po të ishte në rregull kah pjesa e kemi bërë pagesa të detyrueshme, mendoj se me atë të gjeturat që janë të prokurimi, raporti kishte me kaluar dhe kishte me i penalizuar në këtë drejtim. Sidoqoftë raporti na ka ardhur prej çështjeve me të mëdha që janë bërë dhe që janë bërë pagesat në formë jo të rregullt- në formë të detyrueshme, që realisht e kanë edhe shumica e komunave të Kosovës, disa me herët, disa tani e disa me vonë.

z. Bahri Selimi: Janë 24 komuna që e kanë raportin e njëjtë, sa e di unë.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja është e përgjithshme, nuk është vetëm të një komunë. Ai që përfiton GP, sivjet paska para boll.

znj. Ardita Rrahmani: Sa kam informacion, nja 4 komunave iu kanë bllokuar mjetet buxhetore, qysh është puna me komunën tonë.

z. Bahri Selimi: Komuna jonë nuk i ka mjetet e bllokuara, janë mjetet e bartura, ndërkaq mjetet tjera i kemi në rregull. Ato mjete janë në thesar dhe pasi të kryhen pagesat, kanë me u liruar. Edhe këto që jemi duke i pritur nuk janë shumë, janë nja 200 mijë euro, i kemi do mjete për të cilat kemi bërë marrëveshje me gjykatat, si të na i lirojnë ato mjete, kryhen pagesat.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë raportin e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Në saje të kësaj del konstatimi se **KPF, diskutoj Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2024. Ky raport i kalohet KK në procedurë për shqyrtim.**

4.Plan i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Krahas raportit, del edhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të auditorit. Nëse keni kush diçka, urdhëroni:

z. Agim Mani: Ky është plani B i komunës, se po të ishte raporti i mirë, nuk ka pasur nevojë fare për plan të veprimit. Komuna i ka në plan të realizimit të gjeturat, por me e keqja është se në plan janë shumë të gjetura të bartura nga vitet e kaluara, se ka pasur plan edhe me herët, por nuk janë realizuar, kështu do të gjetura janë përsëritur nga viti 2022, 2023. Sidoqoftë para qytetarëve duhet me u arsyetuar komuna me planin e veprimit.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë raportin e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF, **diskutoj**

Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2024. Raporti i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.

5. Raporti Gjashtëmujor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Raportin e keni marrë, nëse ka kush diçka, lë të urdhëroj:

z. Agim Mani: Ky raport që është sjellë i KKSB, nuk është raport, por është informatë, sepse është jashtë kriterëve me një strukturë e këtij këshilli, ku opozita është e përjashtuar nga ky këshill.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse flasim për kompetencën e përbërjes së këtij këshilli, është në kompetenca të KK, dhe i raporton KK. Sa i përket raportit, çështjet që janë me rëndësi, duhet të shënohen në letër.

z. Rrustem Zenuni: Janë disa fenomene që po dëmtojnë imazhin e komunës, si publikimi i lajmeve të pabaza të publikuara në rrjetet sociale, të cilat fenomene e dëmtojnë mjedisin ku jetojmë ne. Në rekomandime është thënë që të ndalohen disa OJQ të cilat po keqpërdorin paratë publike. Për cilat OJQ është fjala, a për këtu të ne, apo në nivel tjetër, është mirë me i saktësuar ato OJQ.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di kur KKSB e ka mbajtur mbledhjen e fundit, ndërkaq duhet të trajtohet çështja e moti të nxehtë në ekstrem si temë, se jemi duke u përballur me temperatura të larta, se ka raste kur djegën pronat, objekte, nuk e di a kanë DSHPE dhe KKSB ndonjë plan, se qysh po dihet ka me zgjatur moti ekstrem që prek krejt rajonin. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë raportin e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. **Në saje të kësaj del konstatimi se KPF, diskutoj Raportin Gjashtëmujor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025. Ky raport i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

6. Propozim Vendimi për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori nuk është këtu, sigurisht ka ndonjë angazhim diku tjetër. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Drejtori nuk është këtu për sqarime, ndërkaq me intereson të di, nga ka lindur kjo ide, për me bërë vlerësimin e rreziqeve të fatkeqësive natyrore? Nëse e shikon si ide është e kompletuar. Nëse e shikon dhe lexon përjashtuar grupet që kanë marrë pjesë në këtë vlerësim, nuk është i kompletuar si vlerësim i rrezikut. Dihet qysh bëhet vlerësimi i rreziqeve, masat -veprimet që duhet me i marrë, se kur për diçka lindë ideja, duhet me pasur edhe përfundimin. Secili në këtë dokument i kanë dhënë mendimet, idetë e tyre, por duhet pasur probabilitet, masat që duhet marrë, sa është shkalla e rrezikshmërisë për të gjitha, nuk parashihet shkalla, masat që duhet të merren e as afati kohor.

Kryesuesi i Kuvendit: Plani nuk është i hartuar për një komunë, por për krejt komuna, dhe secila komuna ia përshtatë komunës vet, pastaj komunat secila ia përshtatë nevojave dhe kërkesat e komunës së saj.

znj. Kadrije Lika-Troni: Vlerësimi i rreziqeve nuk është i kompletuar, nuk është paraqitur gjendja faktike e komunës. A kemi kapacitete dhe a kemi staf të trajnuar për këtë çështje. Në këtë dokument është elaboruar për të ardhmen, ndërkaq gjendjen të cilën e kemi tani dhe qysh me vazhduar tutje, nuk është paraqitur.

Kryesuesi i Kuvendit: Është mirë me u bërë hidrantet, bizneset privat i kanë, por i kanë për veti. Bizneset private e kanë detyrim me i bërë.

z. Rrustem Zenuni: Bizneset private i kanë bërë, por është mirë edhe ne me i bërë.

z. Agim Mani: Bizneset e bëjnë rriskun e sigurisë së shëndetit, ndërkaq këtu kemi të bëjmë, me fatkeqi natyrore.

Kryesuesi i Kuvendit: Hidranti bëhet për shkak me marrë pëlqimin të zjarrfikësit, se nuk mundesh me marrë pëlqimin, nëse nuk e merr pëlqimin, nuk mundesh me marrë lejen e ndërtimit, kjo është me ligj e përcaktuar. Është fjala për këto a vlen, se për privat po e dimë, por për institucionet publike, ndoshta nuk i kanë as në Prishtinë, e lerë me në Kaçanik, se hidranti është i domosdoshëm me qenë në secilin objekt. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Kaçanikut. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11: 41. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e 7 (shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 29.07.2025 (e martë) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



1	Data	02.09.25	Vendi	KAÇANIK
	Idj. org.	Numri	Shtojcë	
	01	60/01-22031	/	

FTESË PËR DISKUTIM PUBLIK

Të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut,

Në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, në pajtim me rregullat ligjore, kam organizuar Diskutim Publik me qytetarët e komunës së Kaçanikut, OJQ dhe Grupe tjera të interesit.

Diskutimi publik do të mbahet me 10 shtator 2025 (e mërkurë) në ora 11:00.

Vendi: Salla e kuvendit, kati i tretë (3).

Tema: Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet: 2027-2028.

Në Diskutim publik, të pranishëm do të jenë: Kryesuesi i Kuvendit, Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale.

Propozim Buxheti do të publikohet në Faqen Zyrtare të Komunës në adresën: <http://kk.rks-gov.net/kacanik/> dhe në Facebook të Komunës.

Qytetarë të nderuar, OJQ dhe Grupe tjera të interesit, Bëhuni pjesë e Diskutimit Publik, që të jeni pjesë e planifikimit buxhetor të vitit fiskal 2026 dhe vlerësimeve për vitet: 2027-2028.

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr. 104/02-22197/25
Kaçanik 02.09.25

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale , nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Ligjit Nr 04/L-060 për mbeturina , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08/L-071 dhe Ligji Nr 04/L-010 për Bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve publike dhe Emergjencës, Kryetari i Komunës bënë këtë:

Propozim

Që Komiteti për Politikë dhe Financa , në mbledhjen e radhës më _____ 2025 të shqyrton dhe aprovon duke e proceduar për procedura të mëtejme në Kuvend të Komunës, pikën e rendit të ditës:

VEDNIM

Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Inetgruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

I

Me këtë Vendim miratohet Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Inetgruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

II

Për zbatimin e këtj Vendimi do të përkujdesen : Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe Inspektorati Komunal

III

Ky Vendim, pas aprovimit në Kuvend Komunal, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL dhe 7- Ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.






REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



DATË	29 gusht 2025
REFERENCË	01-400/01-21750/25
PËR/ZA/TO:	Kemal Mërseli- Kryesues Kuvendi Komunal Kaçanik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Besim Ilazi- Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Valdrin Dogani- Drejtor për Buxhet dhe Financa Gafurr Loku- Zyrtar Kryesor Financiar Komuna e Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Propozim Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2026 dhe vlerësimeve për vitet 2027-2028

I nderuar,

Bazuar në Qarkoren Buxhetore (QB) 2026/02 e cila ofron kufijtë buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), si dhe pas përfundimit të disa dëgjimeve buxhetore me publikun, të organizuara dhe zhvilluara nga ekzekutivi komunal, Kryetari i Komunës dërgon Propozim Buxhetin për vitin 2026 dhe vlerësimet për periudhën afatmesme 2027-2028 .

Bashkangjitur me këtë shkresë, ju dërgojmë:


Propozim Vendimin për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028 si dhe:

- Tabela 4.1 , plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës (2026-2028),
- Tabela 4.2 , financimi vjetor i projekteve kapitale komunale (2026-2028),
- Tabela 4.3 , plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal (2026-2028) dhe
- Shënime shtesë rreth ndarjes projeksioneve financiare .

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik



01-400/01-21750/25

Kaçanik, 29.08.2025

Në bazë të nenit 24 dhe 40.2 (b) të Ligjit nr. 03/L-040– për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61 të Ligjit nr. 03/L-048– për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr. 03/L-049– për Financat e Pushtetit Lokal, Qarkoreve Buxhetore të MFPT 2026, 01 e 02 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës:

Propozon

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës që zhvillohet në muajin shtator 2025, të shqyrton dhe aprovon këtë:

V E N D I M

**PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2026
DHE VLERËSIMET PËR VITET 2027- 2028**

I.

Buxheti i Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2026, është në shumë prej 13,399,753.00 €, ndërkaq për vitet 2027 dhe 2028, vlerësimet e parashikuara janë në këto shuma:
viti fiskal 2027, shuma 14,070,440.00€ dhe viti fiskal 2028, shuma 14,757,058.00€.

II.

Në strukturën e të hyrave buxhetore për vitin fiskal 2026, sipas pikës I. të këtij vendimi, mjetet nga Grantet Qeveritare janë në shumë prej 12,334,620.00 €, që shënojnë pjesëmarrje me 92.05% dhe mjetet nga Të Hyrat Vetanake Komunale, në shumë prej 1,065,133.00€, me pjesëmarrje prej 7.95% në strukturën e përgjithshme të Buxhetit.

III.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2026, parashikohen të jenë për:
Shpenzime Operative, shuma prej 10,192,442.00€ dhe Investime Kapitale, shuma prej 3,207,311.00 € .

IV.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2026, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, parashikohen me këto ndarje buxhetore, të cilat janë në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2026/02, e datës 21.08.2025, e nxjerrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT):

- Paga dhe Shtesa 7,883,305.00€ ,
- Mallra dhe Shërbime1,469,980.00€ ,
- Shpenzime Komunale 225,000.00€ ,
- Subvencione dhe Transfere 614,157.00€ dhe
- Investime Kapitale 3,207,311.00€ .


V.

Për zbatimin e këtij vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Kryetari i Komunës



Besim Ilazi

Besim Ilazi